

VENDIM
Nr.615, datë 8.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.839, DATË 11.12.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, lidhja nr.1 “Paga bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 5/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5/1. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së Forcave të Armatosura dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të gradës përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese, për pozicionet konkrete, bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicionit të punës.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2010.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PAGA BAZË SIPAS GRADËS DHE VITEVE TË SHËRBIMIT PËR USHTARAKËT AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA

	Vitet e shërbimit														
OFICERË	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Gj. Lejtnant (Admiral)															151500
Gj. Major (Nënadmiral)														142390	145000
Gj. Brigade (Kundëradmiral)													112000	114000	114000
Kolonel (Kapiten i rangut I-rë)											88500	90000	92000	93600	96000
Nënkolonel (Kapiten i rangut II-të)									69700	71000	72200	73450	74650	75900	77100
Major (Kapiten i rangut III-të)							54600	55650	56600	57550	59300	60850	61650		
Kapiten (Kapiten lejtant)				48900	49500	50150	50750	51400	52000	52650	53250				
Toger (Lejtnant)			45250	46300	47300	48350	48900								
Nëntoger (Nënlejtant)	41300	42100	42900	43650	44400	45200									
	Vitet e shërbimit														
NËNOFICERË	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
K/Kapter											49920	50960	52520	53560	54600
Kapter								42430	43890	44650	45240	46800	48880		
Rreshter						37230	38790	41180	42430	43890	44650				
Tetar				35280	36230	36750	37590	38330	39170	40100	40850				
Nëntetar	30450	31080	32350	33600	35280	36540									
	Vitet e shërbimit														
USHTARË PROFESIONISTË	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar/detar profesionist II	30350	31600	32860	34150	35280										
Ushtar/detar profesionist I	27830	29100													
USHTARË TË SHËRBIMIT TË DETYRUESHËM E STUDENTË USHTARAKË															
	Vitet e shërbimit														
	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar rekrut II/detar II	2000														
Ushtar rekrut I/detar I	1500														
Studentë ushtarak	1500														

